



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.4.2023

Nr: 372

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**REGJISTRIMIN DHE CAKTIMIN E NUMRIT RENDOR NË FLETËN E VOTIMIT PËR KANDIDATIN
PËR KRYETAR BASHKIE Z. KOSTA GARO, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “NISMA
THURJE”, PËR BASHKINË DROPULL**

Sot, më datë 18.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e z. Kosta Garo, si kandidat për kryetar bashkie, në Bashkinë Dropull, dhe caktimin e numrit rendor në fletën e votimit, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023.

BAZË LIGJORE: Nenet 19, pika 1, shkronja “n” e 2, dhe 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi nr. 9, datë 13.4.2023, i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

V Ë R E J:

Subjekti Zgjedhor “Nisma Thurje”, përfaqësuar nga kryetari, z. Indrit Shabani, ka depozituar në KZAZ nr. 82, kërkesën për regjistrimin e kandidatit z. Kosta Garo, për kryetar Bashkie, në Bashkinë Dropull.

Në mbështetje të nenit 71, të Kodit Zgjedhor, KZAZ nr. 82 me vendimin nr. 10, datë 28.3.2023 ka vendosur: Mosregjistrimin e kandidatit, z. Kosta Garo.

Subjekti Zgjedhor “Nisma Thurje” brenda afatit ligjor, ka ankimuar vendimin e KZAZ-së, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, i cili me vendimin nr. 43, datë 3.4.2023, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit të KZAZ-së nr.82, Dropull.

Subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” ka depozituar kërkesë-padinë, në Kolegjin Zgjedhor me objekt:

Data: 18.4.2023 Nr. 372
Ora:10:00



“Për regjistrimin dhe caktimin e numrit rendor në fletën e votimit për kandidatin për kryetar bashkie, z. Kosta Garo, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, për bashkinë Dropull

-Ndryshimin e vendimit nr. 10, datë 28.3.2023, të KZAZ-së nr. 82, dhe vendimit nr. 43, datë 3.4.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe
-Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të vendosë regjistrimin e subjektit zgjedhor “Nisma Thurje” dhe kandidatit Kosta Garo, si kandidat për kryetar i Bashkisë Dropull, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023.

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 9, datë 13.4.2023 ka vendosur:

1. Pranimin e padisë
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 43, datë 3.4.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe vendimit nr. 10, datë 28.3.2023, të KZAZ-së Nr.82
3. Detyrimin e KQZ/KZAZ nr. 82 të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur
5. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 9 datë 13.4.2023, të Kolegjit Zgjedhor gjyqësor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Regjistrimin e z. Kosta Garo, si kandidat për kryetar bashkie, në bashkinë Dropull, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
2. Caktimin e numrit 3, si numër rendor në fletën e votimit, për kandidatin për kryetar bashkie, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI